

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Raportimi financiar i  
avancuar**

**P9**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data 03.07.2021

1. Gugamal sh.a ka kontroll dhe ndikim domethënës në entitete të ndryshme. Më poshtë janë pasqyrat financiare të konsoliduara të grupit Gugamal.

**Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020:**

	€'000
Të hyrat	2,242
Kosto e shitjeve	<u>(838)</u>
Fitimi bruto	1,404
Kosto e shpërndarjes	(665)
Kosto administrative	(477)
Kosto financiare	(81)
Pjesa e fitimit pas tatimit të ortakërisë	<u>48</u>
Fitimi para tatimit	229
Tatimi	<u>(91)</u>
<b>Fitimi për periudhën</b>	<b>138</b>
<b>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:</b>	
Përfitimi nga rivlerësimi	42
Neto humbja nga vlerësimet e ekspertëve	<u>(12)</u>
<b>Total të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>	<b>168</b>
Fitimi për periudhën i atribuar te:	
Pronarët e prindit	110.40
Interesat jo-kontrollues	<u>27.60</u>
	<b>138.00</b>
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse atribuar te:	
Pronarët e prindit	140.40
Interesat jo-kontrollues	<u>27.60</u>
	<b>168.00</b>

**Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare me 31 dhjetor:**

	2020	2019
	€'000	€'000
<b>Pasuritë</b>		
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Patundshmëritë, impiantet e prodhimit dhe paisjet	1,526	1,177
Zëri i mirë	158	179
Investimi në ortakëri	<u>507</u>	<u>385</u>
	2,191	1,741
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	184	180
Të arkëtueshmet tregtare	292	252
Paraja & ekuivalentët e parasë	<u>328</u>	<u>342</u>
	<u>804</u>	<u>774</u>
<b>Total Pasuritë</b>	<b>2,995</b>	<b>2,515</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>		
<b>Ekuiteti</b>		
Aksionet e zakonshme €5 secila	773	326
Premia e aksioneve	118	28
Fitimet e mbajtura	<u>72</u>	<u>(10)</u>
	963	344
Interesat jo-kontrollues	<u>178</u>	<u>208</u>
Total ekuiteti	1,141	552
<b>Detyrimet</b>		
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
Përfitimet e punonjësve	403	536
Tatimi i shtyrë	48	59
Detyrimet ndaj lizingut	240	180
Kredi bankare	<u>500</u>	<u>612</u>
	1,191	1,387
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>		
Të pagueshmet tregtare	340	234
Detyrimet ndaj lizingut	90	70
Tatimi	111	103
Kosto financiare e pagueshme	<u>122</u>	<u>169</u>
	663	576
Total detyrimet	<u>1,854</u>	<u>1,963</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrime</b>	<b>2,995</b>	<b>2,515</b>

Informatat në vijim janë të rëndësishme:

- (i) Më 31 dhjetor 2020, Gugamal sh.a shiti 60% nga 90% e aksioneve të saj në interesat e ekuitetit të Bontebok sh.a për një shumë parash prej €96,000. Gugamal sh.a e kishte blerë interesin e ekuitetit prej 90% në Bontebok sh.a për një konsideratë në para prej €180,000 me 1 janar 2016. Vlerat e drejta të pasurive neto të Bontebok sh.a ishin €190,000 dhe €170,000 respektivisht me 1 janar 2016 dhe 31 dhjetor 2020. Vlera e drejtë e 30% të aksioneve në Bontebok sh.a me 31 dhjetor 2020 ishte €56,000.

Vlera e drejtë e pasurive neto të Bontebok sh.a prej €170,000 me 31 dhjetor 2020 përbëhet si më poshtë:

	€'000
Patundshmëritë, impiantet e prodhimit dhe paisjet	130
Të arkëtueshmet tregtare	90
Mbitërheqja bankare	(30)
Interesi i pagueshëm	<u>(20)</u>
	<b>170</b>

Gugamal sh.a mbajti ndikim domethënës në Bontebok sh.a. Nuk kishte blerje të filialeve gjatë vitit deri me 31 dhjetor 2020.

- (ii) Gugamal sh.a bleu 40% të aksioneve të zakonshme në Ifrane sh.a me 1 tetor 2020 për një shumë parash prej €41,000. Vlerat e drejta të pasurive neto të Ifrane sh.a €93,000 dhe €97,000 respektivisht me 1 tetor 2020 dhe 31 dhjetor 2020. Gugamal sh.a kishte ndikim domethënës në Ifrane sh.a. Investimet në ortakëri u dëmtuan për €14,000 në 31 dhjetor 2020. Asnjë investim në ortakëri nuk u shit gjatë vitit.
- (iii) Me 31 dhjetor 2020, Gugamal sh.a bleu një pjesë tjetër të makinerisë nën një lizing 5-vjeçar. Makinaria kishte një vlerë të drejtë prej €90,000 dhe një jetë të dobishme ekonomike prej 5 vjetësh. Vlerat tanishme e pagesave të qirasë arriti në €90,000. Në të njëjtin vit, Gugamal sh.a shiti pajisje me një vlerë bartëse prej €69,000 për shumën e parave prej €79,000. Nuk kishte asnjë shitje tjetër të pasurive jo-qarkulluese.
- Fitimi i rivlerësimit ka të bëjë me ndërtesat të cilat janë rivlerësuar për herë të parë në 2018. Ato kishin një humbje të rivlerësimit prej €18,000 në atë vit.
- Zhvlerësimi dhe interesi për detyrimet e qirasë për vitin arritën në €122,000 dhe €29,000 respektivisht.
- (iv) Gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2020, neto shpenzimet e pensionit neto ngarkuar në fitim ose humbje (si pjesë e fitimit operativ) në skemën e përfitimit të përcaktuar arriti në €123,000. Skema ka paguar përfitime pensioni prej €61,000 gjatë vitit.
- (v) Zëri i mirë i konsoliduar u dëmtua gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2020. Kjo përfshinte humbje nga dëmtimi prej €4,000 në lidhje me zërin e mirë në Bontebok sh.a.
- (vi) Gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2020, Gugamal sh.a emetoi aksione të zakonshme të saj për para. Gugamal sh.a gjithashtu pagoi dividendë prej €28,400.
- (vii) Është politikë e grupit Gugamal të vlerësojë interesat jo-kontrollues duke përdorur metodën e pjesës proporcionale të pasurive neto të identifikueshme.
- (viii) Të dy zërat në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse (Fitimi i rivlerësimit dhe neto humbja nga vlerësimet e ekspertëve) gjatë vitit u dërguan tek premia e aksioneve

#### **Kërkohet:**

**Përgatite një pasqyrë të konsoliduar të rrjedhës së parasë të grupit Gugamal duke përdorur metodën indirekte, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020 në pajtim me kërkesat e SNK 7 Pasqyra e Rrjedhës së Parasë. (30 pikë)**

## Grupi Gugamal

### Pasqyra e konsoliduar e Rrjedhës së Parasë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

	€'000
<i>Rrjedhat e parasë nga aktivitetet operative</i>	
Fitimi para tatimit	229.00
Korigjimet:	
Pjesa e fitimit pas tatimit të ortakërisë	(48.00)
Kosto financiare	81.00
Anulimi i rënies të rivlerësimit	(18.00)
Zhvlerësimi	122.00
Neto shpenzimet e pensioneve	123.00
Fitimi nga shitja e paisjes (79 - 69)	(10.00)
Humbja nga shitja e Bontebok sh.a L19	6.00
Dëmtimi i zërit të mirë L12	16.00
Rritja në stoqe (180 - 184)	(4.00)
Rritja në të arkëtueshmet tregtare (252-90 -292]	(130.00)
Rritja në të pagueshmet tregtare (340 - 234)]	106.00
Paraja e gjeneruar nga operacionet	473.00
Kontributet e paguara për pensione L16	(268.00)
Tatimi i paguar L14	(94.00)
Interesi i paguar L17	<u>(79.00)</u>
<b>Neto rrjedha hyrëse e parasë nga aktivitetet operative</b>	<b>32.00</b>
<b>Rrjedhat e parasë nga aktivitetet investuese</b>	
Shitja e aksioneve në Bontebok sh.a (96+30)	126.00
Blera e aksioneve në Ifrane sh.a	(41.00)
Bleraja e patundshmërive, impianteve të prodhimit dhe paisjeve L11	(520.00)
Arkëtimet nga shitja e patundshmërive, impianteve të prodhimit dhe paisjeve	79.00
Dividenda e pranuar nga ortakëritë L13	<u>23.00</u>
<b>Neto rrjedhat dalëse nga aktivitetet investuese</b>	<b>(333.00)</b>
<b>Rrjedhat e parasë nga aktivitetet financuese</b>	
Arkëtimet nga emetimi i aksioneve L10	507.00
Dividendat e paguara IJK-së L15	(40.60)
Pagesat e lizingut L18	(39.00)
Dividenda tjera të paguara	(28.40)
Ripagimi i kredisë (500 - 612)	<u>(112.00)</u>
<b>Neto rrjedha hyrëse nga aktivitetet financuese</b>	<b>287.00</b>
Neto zvogëlimi në para & ekuivalentë të parasë	(14.00)
Paraja & ekuivalentët e parasë në fillim të periudhës	342.00
Paraja & ekuivalentët e parasë në fund të periudhës	328.00

**L11****Patundshmëritë, impiantet e prodhimit dhe paisjet****€'000**

Saldo në fillim	1,177.00
Zhvlerësimi	(122.00)
Shitja e Bontebok sh.a	(130.00)
Shitja e paisjeve	(69.00)
Përfitimi nga rivlerësimi (42+18)	60.00
Pasuritë e marra me lizing pa para	90.00
Blerjet në para (shif. bal.)	<u>520.00</u>
<b>Saldo në fund</b>	<b>1,526.00</b>

**L12****Zëri i mirë****€'000**

Saldo në fillim	179.00
Shitja e Bontebok sh.a [180 - (190 x 90%)]-4	(5.00)
Dëmtimi (shif. bal.)	<u>(16.00)</u>
<b>Saldo në fund</b>	<b>158.00</b>

**L13****Investimet në ortakëri****€'000**

Saldo në fillim	385.00
Investimet në Bontebok sh.a	56.00
Investimet në Ifrane sh.a	41.00
Pjesa e fitimit pas tatimit	48.00
Dividenda e pranuar (shif. bal.)	<u>(23.00)</u>
<b>Saldo në fund</b>	<b>507.00</b>

**L14****Tatimi****€'000**

Saldo në fillim (103 + 59)	162.00
Fitim ose humbje	91.00
Paraja e paguar (shif. bal.)	<u>(94.00)</u>
<b>Saldo në fund (48+111)</b>	<b>159.00</b>

**L15****Interesat jo-kontrollues****€'000**

Saldo në fillim	208.00
Shitja e Bontebok sh.a (10% x 170)	(17.00)
Fitim ose humbje	27.60
Dividenda e paguar (shif. bal.)	<u>(40.60)</u>
<b>Saldo në fund</b>	<b>178.00</b>

<b>L16</b>	
<b>Përfitimet e punonjësve</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim	536.00
Neto humbja nga vlerësimi i ekspertëve	12.00
Neto shpenzimet e pensioneve	123.00
Përfitimet e punonjësve të paguara (61 - 61)	-
Kontributet e paguara	<u>(268.00)</u>
<b>Saldo në fund</b>	<b>403.00</b>

<b>L17</b>	
<b>Interesi i pagueshëm</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim	169.00
Fitimi ose humbja	81.00
Interesi në detyrimet e lizingut	(29.00)
Shitja e Bontebok sh.a	(20.00)
Paraja e paguar (shif. bal)	<u>(79.00)</u>
<b>Saldo në fund</b>	<b>122.00</b>

<b>L18</b>	
<b>Obligimet e lizingut</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim (180+70)	250.00
Makineria e re nën lizing financiar	90.00
Kosto financiare	29.00
Paraja e pranuar (shif. bal)	<u>(39.00)</u>
<b>Saldo në fund (240 + 90)</b>	<b>330.00</b>

<b>L19</b>	
<b>Shitja e 60% aksioneve - Bontebok sh.a</b>	<b>€'000</b>
VD e PN në shitje	170.00
Zëri i mirë (9L12 - 4 dëmtimi)	<u>5.00</u>
	175.00
Minus:	
IJK L15	(17.00)
VD e interesave të mbajtura (30%)	(56.00)
Konsiderata e pranuar	<u>(96.00)</u>
<b>Humbja nga shitja</b>	<b>6.00</b>

<b>L110</b>	
<b>Emetimi i aksioneve të zakonshme</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim (326 + 28)	354.00
Përfitimi nga rivlerësimin në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	42.00
Neto humbja nga vlerësimi i ekspertëve	(12.00)
Paraja e pranuar (shif. bal)	<u>507.00</u>
<b>Saldo në fund (773 + 118)</b>	<b>891.00</b>

## 2.

Evros Delta sh.a prezantoi një skemë të pensioneve në 28 shkurt 2020 si një nga strategjitë e saj për të promovuar mbajtjen e punonjësve të saj. Sidoqoftë, skema u bë funksionale në 1 prill 2020 menjëherë pasi Evros Delta sh.a kishte dhënë një kontribut prej €900,000. Evros Delta sh.a ka garantuar përfitime pensioni të cilat punonjësit do t'i marrin në moshën e pensionit. Të gjithë punonjësit kishin të drejtë, duke përfshirë edhe ata që prisnin të pensionohen në vitin 2020.

Informatat në bijim kanë të bëjë me planin e pensioneve për vitin deri në 31 dhjetor 2020:

- (i) Përfitimet e pensioneve prej €100,000 ishin paguar me 30 shtator 2020.
- (ii) Vlera e drejtë e pasurive të planit ishte €900,000 dhe €920,000 me 1 prill 2020 dhe 31 dhjetor 2020 respektivisht.
- (iii) Vlera e tanishme e obligimeve të pensionit arriti shumën prej €1,200,000 me 1 prill 2020 dhe €1,400,000 me 31 dhjetor 2020.
- (iv) Kostot e shërbimit aktual ishin €120,000.
- (v) Norma e skontimit prej 10% aplikohet.

Drejtorët e Evros Delta sh.a kanë nevojë për këshillën tuaj mbi trajtimin kontabël të skemës pensionale në pasqyrat financiare për vitin deri në 31 dhjetor 2020.

**Kërkohet:**

**Këshilloni Drejtorët e Evros Delta sh.a mbi mënyrën e trajtimit të skemës së pensionit në pasqyrat financiare të kompanisë për vitin deri në 31 dhjetor 2020. (Përgjigja juaj duhet të përfshijë llogaritjet përkatëse. (10 pikë)**



2. Plani i pensionit i prezantuar nga Evros Delta sh.a do të kontabilizohet në përputhje me SNK 19 *Përfitimet e Punonjësve*. Skema do të trajtohet si një plan me përfitime të përcaktuara. Kjo pasi Evros Delta sh.a ka garantuar përfitime pensioni që punonjësit do të marrin gjatë pensionit. Detyrimi i tij nuk kufizohet vetëm në pagesen e kontributeve në plan.

Evros Delta sh.a do të njohë një detyrim neto prej €480,000 L14 si detyrim afatgjatë në pasqyrën e pozitës financiare më 31 dhjetor 2020. Gjithashtu do të njohë një shpenzim neto pensioni prej €142,500 L13 dhe humbje neto vlerësimet e ekspertëve prej €37,500 L11 & L12 (55 -92.5) në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

### Llogaritjet

#### L11

<u>Pasuritë e planit</u>	<b>€'000</b>
Vlera e drejtë me 1 prill 2020	900.00
Përfitimet e paguara	(100.00)
Interesi(10% x 900 x 6/12) +(10% x 800 x 3/12)	65.00
Fitimet nga vlerësimet e ekspertëve (shif.bal)	<u>55.00</u>
Vlera e drejtë me 31 dhjetor 2020	920.00

#### L1 2

<u>Obligimet e planit</u>	<b>€'000</b>
Vlera e tanishme me 1 prill 2020	1,200.00
Interesi (10% x 1,200 x 6/12) +(10% x €1,100 x 3/12)	87.50
Kosto e shërbimit aktual	120.00
Përfitimet e paguara	(100.00)
Humbjet nga vlerësimet e ekspertëve (shif.bal)	<u>92.50</u>
Vlera e tanishme me 31 dhjetor 2020	1,400.00

#### L1 3

Neto shpenzimet e pensioneve	<b>€'000</b>
Kosto e shërbimit aktual	120.00
Neto shpenzimi i interesit (87.5 - 65)	<u>22.50</u>
Neto shpenzimet	142.50

#### L1 4

Neto obligimet e pensioneve	<b>€'000</b>
Vlera e tanishme me 31 dhjetor 2020 (L1 2)	1,400.00
Vlera e drejtë me 31 dhjetor 2020 (L1 1)	<u>(920.00)</u>
Neto detyrimi	480.00

3. Në vijim janë llogaritë e Timanfaya sh.a, një kompani që prodhon paisje për zbavitje, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020.

**Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor**

	<b>2020</b>	<b>2019</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Fitimi para interesit dhe tatimit	2,200	1,570
Shpenzimet e interesit	<u>(170)</u>	<u>(150)</u>
Fitimi para tatimit	2,030	1,420
Tatimi	<u>(730)</u>	<u>(520)</u>
Fitimi pas tatimit	1,300	900
Dividenda e paguar	<u>(250)</u>	<u>(250)</u>
Fitimi i mbajtur	1,050	650

**Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2020**

	<b>2020</b>	<b>2019</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Pasuritë jo-qarkulluese (vlera neto)	6,350	5,600
Pasuritë qarkulluese		
Të arkëtueshmet tregtare	2,100	2,070
Stoqet	<u>1,710</u>	<u>1,540</u>
Total pasuritë qarkulluese	3,810	3,610
<b>Kreditorët: shumat që duhet të paguhën brenda 1 viti</b>		
Të pagueshmet tregtare	1,040	1,130
Tatimi	550	450
Mbitërheqja bankare	<u>370</u>	<u>480</u>
Total detyrimet afatshkurtëra	<u>1,960</u>	<u>2,060</u>
Neto pasuritë qarkulluese	1,850	1,550
<b>Total neto pasuritë</b>	<b>8,200</b>	<b>7,150</b>
<b>Kreditorët: shumat që duhet të paguhën pas 1 viti</b>		
10% obligacione 2022	1,500	1,500
<b>Ekuiteti:</b>		
Kapitali aksionar (aksione të zakonshme prej 50 cent secila)	3,000	3,000
Fitimet e mbajtura	<u>3,700</u>	<u>2,650</u>
	<u>6,700</u>	<u>5,650</u>
<b>Detyrimet afatgjata dhe ekuiteti</b>	<b>8,200</b>	<b>7,150</b>

**Kërkohet:**

- a) Llogariti për të dy vitet, kthimin në ekuitet dhe kthimin në kapitalin e angazhuar. (4 pikë)
- b) Llogariti për të dy vitet, DY (2) koeficient të investitorëve që janë me interes të një investitori potencial. (4 pikë)
- c) Llogariti për të dy vitet, DY (2) koeficient me interes të një huadhënësi afatgjatë. (4 pikë)
- d) Reporto lidhur me performancën dhe gjendjen e kompanisë nga një këndvështrim i një aksionari dhe i një huadhënësi potencial duke përdorur koeficientt e mësipërm dhe shpjego ndonjë dobësi (mangësi) në këta koeficient. (8 pikë)

### a) Llogaritja e kthimit në ekuitet dhe kthimit në kapitalin e angazhuar

*Kthimi në ekuitet = Fitimi pas tatimit / Ekuiteti × 100%*

2020 KNE =  $1,300 / 6,700 \times 100 = 19.4\%$

2019 KNE =  $900 / 5,650 \times 100 = 15.93\%$

*Kthimi në kapitalin e angazhuar =*

*Fitimi para interesit dhe tatimit / Total pasuritë-detyrimet afatshkurtëra (Kapitali i angazhuar) × 100%*

2020 KNKA =  $2,200 / 8,200 \times 100 = 26.83\%$

2019 KNKA =  $1,570 / 7,150 \times 100\% = 21.96\%$

### b) Llogaritja e koeficientëve të investitorëve

*Dividenda për aksion = Dividenda e paguar / Numri i aksioneve të zakonshme*

2020, DPA =  $250 / 6,000 = 0.042$  për aksion

2019, DPS =  $250 / 6,000 = 0.042$  për aksion

*Fitimi për aksione = Fitimi që i'u takon aksionarve / Numri i aksioneve të zakonshme*

2020, FPA =  $1,300 / 6,000 = 0.22$

2019, FPA =  $900 / 6,000 = 0.15$

*Mbulimi i dividendës = FPA / DPA*

2020 =  $0.22 / 0.042 = 5.23$  here

2019 =  $0.15 / 0.042 = 3.57$  here

*Koeficienti i pagesës së dividendës = DPA / FPA*

2020 =  $0.042 / 0.22 \times 100\% = 19.23\%$

2019 =  $0.042 / 0.15 \times 100\% = 27.78\%$

### c) Llogaritja e koeficientëve në interes të një huadhënësi afatgjatë

*Koeficienti i hyrjes në borxh = Borxhi nga interesi / (Total Borxhi nga Interesi + Ekuiteti)*

2020 =  $1,500 / (6,700 + 1,500) = 18.29\%$

2019 =  $1,500 / (5,650 + 1,500) = 20.91\%$

*Leverazhi = Totali i mëparshëm i kapitalit / Ekuiteti*

2020 =  $1,500 / 6,700 = 22.39\%$

2019 =  $1,500 / 5,650 = 26.55\%$

%

*Mbulimi i interesit: FPIT / Interesi i pagueshëm*

2020 =  $2,200 / 170 = 12.9$  here

2019 =  $1,570 / 150 = 10.5$  here

#### **d) Raporti mbi performancën dhe gjendjen e biznesit nga këndvështrimi i një aksionari potencial dhe dobësitë në koeficientët**

Nga këndvështrimi i një aksionari potencial i cili do të ishte i interesuar në kthimet në investimin e tij, koeficientët si kthimi i kapitalit, kthimi në kapitalin e angazhuar, dividenda për aksion, fitimet për aksion, fitimi nga dividendat dhe mbulesa e dividendëve do të ishin thelbësore për vlerësimin performancën e biznesit

Kthimi në ekuitet na tregon kthimet nga përdorimi i fondit të aksionerëve dhe kjo është rritur nga 15.93% në 19.4% midis 2019 dhe 2020. Kjo do të thotë që biznesi po performon mirë. Kthimi në kapitalin e angazhuar, na tregon se si janë përdorur pasuritë totale minus detyrimet afatshkurtëra për të gjeneruar kthime. Biznesi ka një performancë të përmirësuar, sepse ka rritur kthimin e saj në kapital të angazhuar me 4.87pp (26.83-21.96) midis 2019 dhe 2020

Fitimet për aksion na tregojnë për fitimet pas interesit dhe tatimit që i atribuohen aksionerëve të zakonshëm dhe kjo është rritur nga 0.15 cent në 0.22 cent. Kjo mund të rrisë besimin e aksionerëve në biznes nga këndvështrimi i huadhënësit, të cilët do të interesoheshin se si biznesi mund ta paguajë investimin.

Koeficienti i hyrjes në borxh flet për raportin e borxhit ndaj borxhit dhe ekuiteti. Zakonisht, një raport borxhi më pak se 50% konsiderohet i pranueshëm. Biznesi ka arritur të zvogëlojë këtë raport brenda periudhës në shqyrtim. Leverazhi na tregon për raportin e borxhit afatgjatë në biznes. Përsëri, biznesi ka performuar mirë për ta zvogëluar atë ndërmjet dy viteve. Kjo do të rrisë mundësinë e saj për të marrë më shumë huazime nëse është e nevojshme.

Më tej, një koeficient i leverazhit më pak se 100% thuhet se është me leverazh të ulët dhe është i pranueshëm pasi kompania varet më pak nga huazimet. Ekziston një zvogëlim i rrezikut që pak fitime do të jetë në dispozicion për shpërndarje tek aksionarët e zakonshëm.

Mbulesa e interesit na tregon nëse biznesi ka fituar mjaft fitim para interesit dhe tatimit për të paguar koston e tij të interesit. Nga analiza, biznesi ka realizuar mjaft FPIT për t'i paguar koston e interesit me 10.5 herë në 2019 dhe 12.9 herë në 2020. Mund të konkludohet se gjendja e biznesit aktualisht është e mirë dhe e pranueshme. Është përmirësuar në performancën e saj midis 2019 dhe 2020.

#### Dobësitë e koeficientëve

- Koeficientët e llogaritur nuk janë qëllim në vetvete. Do të kërkohej një analizë më e detajuar për të nxjerrë ndonjë përfundim kuptimplotë.
- Meqenëse koeficientët bazohen në pasqyrat e kontabilitetit, ato matin atë që ka ndodhur në të kaluarën dhe jo domosdoshmërisht atë që do të ndodhë në të ardhmen.
- Interpretimi i koeficientëve nganjëherë varet nga mënyra se si është formuluar koeficienti.
- Politikat e kontabilitetit të kompanisë mund të kenë ndikuar në rezultatet e këtyre koeficientëve. Metodot e ndryshme të kontabilitetit mund të kenë një ndikim në koeficientët financiarë. Prandaj, koeficientët mund të mos pasqyrojnë ndryshime reale në operacionet dhe shëndetin financiar të kompanive.
- Bërja e krahasimeve ndërmjet industrive mund të jetë e vështirë. Kompanitë në industri të ndryshme kanë tendencë të kenë koeficientë të ndryshëm financiarë.

#### 4.

a) Kruger sh.a zotëron një ndërtesë bllok zyrash të cilën e bleu 20 vjet më parë (1 janar 2001) me një kosto prej €20 milion. Kompania kishte vlerësuar jetën e dobishme ekonomike të ndërtesës si 50 vjet (zhvlerësim linear me një vlerë të mbetur zero). Kruger sh.a ka kontabilizuar ndërtesën në përputhje me modelin e rivlerësimit sipas me the SNK 16 *Pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe paisjet*.

Ndërtesa u rivlerësua për herë të fundit në një vlerë të drejtë prej €10.2 milion në 31 dhjetor 2018 (kur jeta e saj e dobishme ekonomike ishte 32 vjet). Për shkak të përmbytjeve të shkaktuara nga reshjet e mëdha të shiut gjatë dhjetorit 2019, një pjesë e themelit të ndërtesës u shemb. Punonjësit u evakuuan dhe ndërtesa aktualisht nuk është e zënë. Më 1 prill 2020, Kruger sh.a mori një vendim për të shitur ndërtesën. Sidoqoftë, pasi u këshilluan nga vlerësues të pavarur se ndërtesa do të merrte një vlerë të drejtë prej €9.9 milion nëse shitet në gjendjen e saj aktuale, drejtorët kanë vendosur që ndërtesa duhet të reklamohet për shitje vetëm pasi të ndërmarrin riparime për të rregulluar themelin e shembur. Kompania më pas ka kryer riparimet me një kosto prej €1 milion të cilat përfunduan më 30 nëntor 2020. Vlera e drejtë e ndërtesës pas riparimeve është rritur në €13.1 milion, megjithëse nuk është shpallur ende për shitje. Kostot e shitjes në formën e komisionit të agjentit janë 5% e çmimit të shitjes. Vlera aktuale e rrjedhave monetare operative të ardhshme nga përdorimi i vazhdueshëm i ndërtesës u vlerësua në 31 dhjetor 2020 në €14.6 milion. Supozoni se ndërtesa nuk është dëmtuar kurrë para 31 dhjetorit 2020.

Kruger sh.a ende nuk ka ngarkuar ndonjë zhvlerësim për vitin deri në 31 dhjetor 2020 dhe po propozon që ta trajtojë ndërtesën si një pasuri jo-qarkulluese të mbajtur për shitje në përputhje me SNRF 5 *Pasuritë jo-qarkulluese të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera* megjithëse kompania nuk është e sigurt nëse ky është trajtimi i duhur në kontabilitet. Prandaj drejtorët po kërkojnë këshilla për kërkesat e SNRF 5 në lidhje me pasuritë jo-qarkulluese të mbajtura për shitje dhe nëse ato kërkesa zbatohen në këtë rast.

#### **Kërkohet:**

**Këshilloni drejtorët e Kruger sh.a se si të trajtohen çështja e ngritur më lart në përputhje me standardet e aplikueshme të kontabilitetit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020. (10 pikë)**

b) Me 1 janar 2020, Iguazu sh.a hyri në një marrëveshje me një kompani të SH.B.A-së në të cilën të dy kompanitë themelojnë një entitet të veçantë juridik Tatra sh.a me seli në SH.B.A. Tatra sh.a kryen këshillime marketingu për një sërë klientësh në industri të ndryshme brenda SH.B.A-ve dhe vendeve të tjera në rajonin Amerikës veriore. Tatra sh.a u inkorporua në 1 janar 2020 me një kapital fillestar prej 10 milion USD (Dollar Amerikan) në të cilin Iguazu sh.a kontribuoi 50% me partnerin e SH.B.A-së që kontribuoi në pjesën e mbetur. Iguazu sh.a dhe partneri i SH.B.A-ve kanë kontroll të përbashkët të Tatra sh.a. Nuk ka pasur asnjë ndryshim në kapitalin aksionar të Tatra sh.a që nga themelimi.

Është politikë e Iguazu sh.a-së që të përdorë metodën e ekuitetit në përputhje me SNK 27 *Pasqyrat Financiare të Veçanta* në lidhje me investimet në sipërmarrje të përbashkëta.

Më poshtë është një ekstrakt nga rezultatet e Tatra sh.a për vitin deri në 31 dhjetor:

	<b>USD'000</b>
Fitimi operativ	650
Kosto financiare	<u>(50)</u>
Fitimi para tatimit	600
Tatimi në fitim	<u>(80)</u>
<b>Fitimi për vitin</b>	<b>520</b>

Tatra sh.a nuk ka të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin deri me 31 dhjetor 2020 dhe kompania nuk ka deklaruar asnjë dividend deri më tani

Kurset e këmbimit ndërmjet Euro dhe USD kanë levizur si në vijim:

<b>Data</b>	<b>Kursi (1 EUR për USD)</b>
1 janar 2020	0.90
31 dhjetor 2020	0.99
Mesatarja për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020	0.95

Valuta funksionale Iguazu sh.a is Euro përderisa ajo e Tatra sh.a është USD.

Drejtorët e Iguazu sh.a kërkojnë këshilla se si të kontabilizojnë investimin në Tatra sh.a në pasqyrat financiare të Iguazu sh.a për vitin deri me 31 dhjetor 2020, përfshirë ekstraktet e shumave.

**Kërkohet:**

**Këshilloni drejtorët e Iguazu sh.a se si të trajtohen çështja e ngritur më lart në përputhje me standardet e aplikueshme të kontabilitetit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020.**

**(10 pikë)**

#### 4.

##### a)

Trajtimi kontabël i ndërtesës do të varet nga fakti nëse ajo kualifikohet si e mbajtur për shitje në përputhje me SNRF 5 *Pasuritë jo-qarkulluese të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera*. Nga momenti që një pasuri kualifikohet si e mbajtur për shitje (MPSH), SNRF 5 bëhet i zbatueshëm. Nëse kërkesat e MPSH nuk plotësohen, ndërtesa do të vazhdojë kryesisht të bjerë brenda fushës së SNK 16 *Pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe paisjet dhe SNK 36 Dëmtimi i pasurive* nëse është dëmtuar.

Një pasuri jo - qarkulluese (ose grup i pasurive të lëna për t'u larguar [shitur]) duhet të klasifikohet si e mbajtur për shitje në qoftë se vlera e saj e bartur do të duhet të realizohet kryesisht me anë të një transaksioni shitjeje në vend të përdorimit të vazhdueshëm të saj. Për këtë duhet të përmbushen disa kritere të detajuara:

- (a) Pasuria duhet të jetë në dispozicion për shitje të menjëhershme në kushtet e saj aktuale.
- (b) Shitja e saj duhet të jetë shumë e mundshme (pra, të ketë më shumë mundësi për po se sa për jo).

Që shitja të jetë shumë e mundshme, duhet të jenë të zbatueshme elementet e mëposhtme.

- (a) Menaxhmenti duhet të jetë i angazhuar ndaj një plani për të shitur pasurinë.
- (b) Duhet të ketë një program aktiv për të gjetur një blerës.
- (c) Pasuria duhet të jetë vënë për shitje me një çmim i cili është arsyeshmërisht në përputhje me vlerën e drejtë aktuale.
- (d) Shitja duhet të pritët të kryhet brenda një viti nga data e klasifikimit.
- (e) Ka shumë pak gjasa që planit t'i bëhen ndryshime të rëndësishme ose që plani të tërhiqet.

Nga momenti kur punonjësit u evakuuan nga ndërtesa, është e qartë se ndërtesa nuk ka qenë në dispozicion për shitje të menjëhershme. Menaxhmenti i Kruger sh.a dëshironte që së pari të riparohej ndërtesa. Pas riparimeve, nuk ka asnjë program aktiv për të gjetur një blerës ose për të shitur në mënyrë ndërtesën. Si përfundim, ndërtesa nuk kualifikohet të trajtohet si e mbajtur për shitje. Prandaj, Kruger sh.a duhet të kontabilizoj ndërtesën në përputhje me SNK 16.

#### Aplikimi i SNK 16 dhe SNK 36

Pasi që asnjë dëmtim nuk ka ndodhur në ndërtesë në të kaluarën, me një rivlerësim të fundit me një vlerë të drejtë €10.2 milion më 31 dhjetor 2018, vlera kontabël e vlerës së ndërtesës do të ndryshojë si më poshtë deri më 31 dhjetor 2020:

	€'000
VD (vlera bartëse) 1 janar 2019	10,200
Minus zhvlerësimi pasues:	
31 dhjetor 2019 (10,200/32)	<u>(319)</u>
Shuma bartëse e raportuar me 31 dhjetor 2019 ose 1 janar 2020	9,881

Minus zhvlerësimi pasues:	
31 dhjetor 2020 (9,881/31)	<u>(319)</u>
Shuma bartëse e raportuar me 31 dhjetor 2020 para humbjes nga dëmtimi	9,562
Humbja nga dëmtimi (shih më poshtë)	-
Shuma bartëse e raportuar me 31 dhjetor 2020 para rivlerësimit	9,562
Përfitimi nga rivlerësimi/(humbja)	<u>3,538</u>
Vlera e drejtë e raportuar në PPF me 31 dhjetor 2020	13,100

**Shenim:**

Pas përmbyttjes, në përputhje me SNK 36 që të bëhet një rishikim i dëmtimi për të vlerësuar nëse ndërtesa është dëmtuar apo jo. Na është thënë që ndërtesa nuk ishte dëmtuar para datës 31 dhjetor 2020. Një përmbledhje më 31 dhjetor 2020 është si më poshtë:

**€'000**

- Shuma e rikuperueshme më 31 dhjetor 2020 është më e larta e:

- Vlera e drejtë minus kostot e shitjes 95% x 13.1 milion 12,445
- Vlera në përdorim 14,600

Prandaj shuma e rikuperueshme është 14,600

- Shuma e mbartur në 31 dhjetor 2020 është 9,562

Shuma e bartur është nën shumën e rikuperueshme. Prandaj, pasuria nuk është dëmtuar me në 31 dhjetor 2020.

Sidoqoftë, meqenëse kompania ndjek modelin e rivlerësimit të SNK 16, pasuria duhet të rivlerësohet nëse vlera e drejtë prej 13.1 milion gjykohet të jetë materialisht e ndryshme nga vlera e saj kontabël prej €9.562 milion duke dhënë një tepricë rivlerësimi prej €3.538 milion. Me një vlerë kostoje që bart vlerën e €12 milion në 31 dhjetor 2020 (dmth. 20 - 20 / 50 x 20). Teprica e rivlerësimit duhet të raportohet si më poshtë:

- Shuma e fitimit që rikthen sakdon e modelit të kostos në ndërtesë që arrin në €2,438 milion duhet të raportohet në F/H për vitin 31 dhjetor 2020.

- Pjesa e mbetur e fitimit që arrin në €1.1 milion do të raportohet në TTGJ.

Kostot e riparimit €1 milion duhet të trajtohen si shpenzime pasuese që do të ngarkohen në F/H për vitin 31 dhjetor 2020.



b)

Është politikë e Iguazu sh.a është të përdorë metoden ekuitetit në lidhje me interesat e saj në sipërmarrje të përbashkëta në pasqyrat e saj financiare të veçanta siç lejohet në SNK 27 *Pasqyrat Financiare të Veçanta* që kundërshtojnë përdorimin e kërkesave të SNRF 9 *Instrumentet Financiare* që trajton kryesisht të gjitha investimet pavarësisht nga niveli të kontrollit si pasuri të thjeshta financiare në pasqyrat financiare të veçanta të investitorit. Prandaj, Iguazu sh.a do të raportojë interesin e saj në Tatra sh.a si një pasuri jo-qarkulluese, "Investime në Sipërmarrje të Përbashkët", vlerësuar me kosto plus pjesën e rezervave pas blerjes. Në PFHTGJ, Iguazu sh.a do të raportojë pjesën e saj të fitimit të Tatra sh.a për vitin në F/H nën fitimin operativ, por si pjesë e FPT nën titullin "Pjesa e Fitimit të Sipërmarrjes së Përbashkët për vitin" dhe pjesën e saj të TTGJ të Tatra sh.a për vitin vit në TTGJ nën titullin "Pjesa e sipërmarrjes së përbashkët TTGJ"

Pasqyrat financiare të Tatra sh.a do të kërkojnë përkthim, në përputhje me SNK 21 *Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit*, nga USD në Euro para llogaritjes së shumave që do të raportohen nga Iguazu sh.a në pasqyrat e saj financiare. Përkthimet janë si më poshtë:

Përkthimi i rezultateve pas blerjes së Iguazu sh.a deri në 31 dhjetor 2020:

	USD'000	Kursi (EUR/USD)	€'000
Neto pasuritë me 31 dhjetor 2020 (10,000+520)	10,520	0.99	10,626
Minus neto pasuritë me 1 janar 2020	(10,000)	0.90	(11,111)
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	520		(485)
Fitimi për vitin	520	0.95	547
Diferencat e ripërkthimit (saldo)	-		(1,032)
	520		(485)

Një ndryshim i ripërkthimit lind në përkthimin e pasqyrave financiare të Tatra sh.a. Dallimet e ripërkthimit të neto pasurive të operacioneve të huaja raportohen si TTGJ (zërat që riklasifikohen në F/H) në përputhje me SNK 21 *Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit*.

Ekstraktet nga pasqyrat financiare të Iguazu sh.a për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 në lidhje me interesin e saj në Tatra sh.a do të jenë si më poshtë:

	€'000
<b>PFHTTGJ</b>	
F/H Pjesa e fitimit për vitin 50% x 547	273.5
TTGJ - Zërat që riklasifikohen në F/H	
Pjesa e diferencave të ripërkthimit 50%x (1,032)	(516)
<b>PPF</b>	
Investimet në SP (50% x 10,000/0.99 - 50% x 485)	4,808

5.

a) SNRF-ja për EVM-të është e përshtatshme për të gjitha entitete përveç atyre letrat me vlerë të të cilave tregtohen publikisht dhe institucioneve financiare si bankat dhe kompanitë e sigurimit. Është seti i parë i kërkesave ndërkombëtare të kontabilitetit i zhvilluar posaqërisht për entitet e madhesisë së vogël dhe të mesme (EVM). Edhe pse është përgaditur në baza të ngjajshme me SNRF-të, është një produkt i vetëm dhe do të freskohet në bazën e tij kohore.

*Shenim: Entitet e madhesisë së vogël dhe të mesme (EVM) është njëjtë me Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM)*

**Kërkohet:**

**Tregoni shkurtimisht thjeshtësimet kryesore të njohjës dhe matjës të SNRF-së për NVM-të.  
(10 pikë)**

b) Harmonizimi në kontabilitet ka gjasa të vijë nga standardet ndërkombtare të kontabilitetit, por jo në të ardhmen e afërt. Ka vështirësi të mëdha për ti tejkaluar, edhe teknike edhe politike.

**Kërkohet:**

**Diskutoni shkurtimisht se cilat janë pengesat dhe përparësitë e harmonizimit global.  
(10 pikë)**

a)

- **Instrumentet financiare**

Instrumentet financiare që përmbushin kriteret e caktuara maten sipas kostos ose kostos së amortizuar. Të gjitha të tjerat maten sipas vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Procedura për mosnjohjen është thjeshtësuar, siç janë thjeshtësuar kërkesat e kontabilitetit.

- **Zëri i mirë dhe pasuritë e patrupëzuara me jetëgjatësi të pakufizuar**

Këto gjithmonë amortizohen përgjatë jetës së tyre të vlerësuar të përdorimit (ose dhjetë vite nëse nuk mund të vlerësohet)

- **Investimet në ortakëritë dhe sipërmarrjet e përbashkëta**

Këto mund të maten sipas kostos, por vlera e drejtë duhet të përdoret nëse ka një kuotim të publikuar të çmimit.

- **Kosot e zhvillimit dhe hulumtimit dhe kostot e huamarrjës duhet të shpenzohen.**

- **Pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe pasijet dhe pasuritë e patrupëzuara**

Nuk ka nevojë të rishikohet vlera e mbetur, jeta e përdorimit dhe metoda e zhvlerësimit përveç nëse ka një indikacion që ato kanë ndryshuar që nga data e fundit e raportimit.

- **Planet me përfitime të përcaktuara**

Të gjitha fitimet dhe humbjet e vlerësimeve të ekspektit duhet të njihen menjëherë (në fitim ose humbje ose të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse). Të gjitha kostot e kaluara të shërbimeve duhet të njihen menjëherë në fitim ose humbje. Për të matur obligimin e përfitimit të paracaktuar, metoda e njësisë së projektuar të kredisë duhet të përdoret.

**Shënim.** SNK 19 është rishikuar dhe ka inkorporuar këto thjeshtësime.

- **Tatimi në të ardhura**

Kur është publikuar, *SNRF për NVM-të* tha se do të ndiqte DE *Tatimi në të hyra*, që është një version me i thjeshtësuar i SNK 12. Ky DE është tërhequr, por ka gjasë që trajtimi i tatimit në të hyra të jetë më i thjeshtë në *SNRF për NVM-të* kur ky të zëvendësohet.

- **Pasuritë në dispozicion për shitje**

Nuk ka klasifikim të ndarë në dispozicion për shitje; mbajtja e një pasurie apo grupi të pasurive për shitje është një tregues i dëmtimit.

- **Pasuritë biologjike**

NVM-të do të përdorin modelin e kostos-zhvlerësimit-dëmtimit përveç nëse vlera e drejtë përcaktohet shumë lehtë, rast në të cilin kërkohet modeli i vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

- **Pagesat e bazuara në aksion apo me aksione**

Nëse çmimet e vëzhgueshme në treg nuk janë në dispozicion për të matur vlerën e drejtë e pagesave të bazuara në aksione apo me aksione, përdoret vlerësimi më i mirë i drejtorëve.

b)

Pengesat e harmonizimit

Padyshim se ka shumë pengesa drejt harmonizimit ndërkombëtar: nëse nuk do të kishte mësiguri se do të ishte arritur progress më i madh deri me tani. Problemet kryesore janë si vijon:

- *Qëllimet e ndryshme të raportimit financiar.* Në disa vende qëllimi është vetëm për vlerësim të tatimit, përderisa në të tjerat është për marrjen e vendimeve nga investitorët.
- *Sisteme të ndryshme ligjore.* Këto ndalojnë zhvillimin e disa praktikave të kontabilitetit dhe kufizojnë opcionet në dispozicion.
- *Grupe të ndryshme të përdoruesve.* Vendet kanë ide të ndryshme për grupet përkatëse të përdoruesve dhe rëndësinë e tyre. Në SHBA grupeve të investitorëve dhe kreditorëve u jipët më shumë rëndësi përderisa në Europë punonjësit kanë profil më të lartë. Nevojat e vendeve në zhvillim.
- *Vendet në zhvillim janë ndoshta më prapa* në procesin e vënies së standardeve dhe ato kanë nevojë të zhvillojnë standarde bazike dhe parimet që aktualisht janë në fuqi në shumë vende të zhvilluara.
- *Diferencat kulturore* rezultojnë në objektiva për sisteme të kontabilitetit që dallojnë nga vendi në vend.
- *Rrethanat unike.* Disa vende mund të jenë duke përjetuar rrethana të pazakonta të cilat afektojnë të djitha aspektet e jëtës së përditshme dhe dëmtojnë aftësinë e kompanive për të përgaditur raporte të duhura, për shëmbull, hiperinflacioni, lufta civile, kufizimet valutore e kështu me rradhë.
- *Mungesa e organizatave të kontabilitetit.* Shumë vende nuk kanë oraganizata ta pavarura të kontabilitetit dhe biznesit të cilat bëjnë presion për standarde më të mira dhe harmonizim më të madh.

Këto janë probleme të vështira për tu kaluar, dhe akoma përpjekjet po bëhen për ti kaluar. Andaj ne duhet të marrim parasysh se cilat janë përparësitë e përceptuara të harmonizimit që arsyetojnë gjithë këtë përpjekje.

#### *Përparësitë e harmonizimit global*

Përparësitë e harmonizimit di të bazohen në përfitimet e përdoruesve dhe përgaditësve të pasqyrave, si vijon:

- *Investitorët, edhe individual edhe korporatat, do të ishin në gjendje të krahasojnë rezultatet financiare të kompanive të ndryshme ndërkombëtare si dhe kombëtare në marrjen e vendimeve investuese.* Dallimet në praktikën e kontabilitetit dhe raportimit mund të paraqiten si pengesë në analizat e tilla ndër-kufitare. Ka një rritje të shumës së investimeve përtej kufive dhe ka disa shembuj ku analistët financiar nuk janë në gjendje të përcjellin aksionet në tregjet ndërkombëtare. Për shëmbull, nuk është e lehtë për një analist i njohur me parimet e kontabilitetit në MB të analizoj pasqyrat financiare e një kompanie të Gjermanisë apo Holandës. Harmonizimi do të i ndihmonte një analize të tillë.
- *Kompanitë multinationale* do të mund të përfitonin nga harmonizimi për shumë arsye përfshirë të mëposhtmet.
  - Qasje më të mirë në fondet e huaja të investimeve.
  - Kontrolli i menaxhmentit do të përmirësohej, sepse harmonizimi do të ndihmonte komunikimin e brendshëm të informative financiare.
  - Vlerësimet e entiteteve të huaja për blerjet apo bashkimet do të ishin më të drejtëpërdrejta.
  - Do të ishte më e lehtë të jemi në pajtueshmëri me kërkesat e raportimit në bursat e vendeve tjera.

- Konsolidimi i filialeve të huaja dhe kompanive ortakëri do të ishte më i lehtë.
  - Një zvogëlim i kostove mund të arrihej.
  - Transferi i stafit të kontabilitetit ndërmjet kufijve do të ishte më i lehtë.
- 
- *Qeveritë e vendeve të zhvilluara* do të kursenin kohë dhe para nëse do të adoptonin standardet ndërkombëtare dhe, nëse këto do të përdreshin Brenda vendit, qeveritë e vendeve të zhvilluara do të tentonin të kontrollojnë aktivitetet e kompanive ndërkombëtare të huaja në vendet e tyre. Këto kompani nuk do të mund të 'fshihen' prapa praktikave të huaja të kontabilitetit të cilat janë të vështira për tu kuptuar.
  - *Autoritetet tatimore.* Do të ishte më e lehtë të llogaritet detyrimin tatimor i investitorëve, përfshirë kompanitë ndërkombëtare të cilat pranojnë të hyra nga burimet jashtë vendit.
  - *Grupet regjionale ekonomike* zakonisht promovojnë tregtinë brenda një regjioni të caktuar gjeografik. Kjo do të ndihmohej nga praktikatat e përbashkëta të kontabilitetit brenda një regjioni.
  - *Kompanitë e mëdha ndërkombëtare* të kontabilitetit do të përfitonin pasi që kontabilitetit dhe auditimi do të ishin më të lehta nëse praktikatat e ngjashme të kontabilitetit do të ekzistonin në botë.